



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
Nr. 1857/S Prot.  
Datë 30.12.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**V E N D I M**

Nr. 1096, datë 24.12.2020

**PËR**

**MIRATIMIN E BUXHETIT PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE, PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për vitin 2021, për shumën 392 000 000 (treqind e nëntëdhjetë e dy milionë) lekë, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

Në mungesë dhe me porosi

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRACE**

MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

## PASQYRA NR.1

**PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2021**

<b>Të ardhura</b>	<b>Në mijë lekë</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>Në mijë lekë</b>
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	170,000	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	109,800
Të ardhura nga pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave	132,000	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	15,000
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26,000	Shpenzime për materiale	8,850
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	20,160	Shpenzime për shërbime	150,967
Të ardhura nga mbikëqyrja e tregut të shërbimit postar	9,000	Shpenzime për investime	107,382
Të ardhura nga pagesa për <i>domain</i>	9,500		
Të ardhura nga pagesa dhe të ardhura të tjera	340		
Të ardhura nga Komisioni nga agjenti tatimor	25,000		
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>392,000</b>	<b>Totali shpenzimeve</b>	<b>392,000</b>

NR.PROT. 6498/1  
DATË 28.12. 2020

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE  
ENERGJISË  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AKEP-IT  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

Engjell AGAÇI  
  
